



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
LIPJAN



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF

Bazuar në dispozitat e neneve 12 paragrafi 12.2 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , si dhe neneve 9, 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.02.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE KAPITALE ME PRIORITET PËR**  
**BASHKËFINANCIM PËR VITIN 2023**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, **APROVON**, listën e projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023, për aplikim te donatorët dhe Ministrinë e ndryshme në Republikën e Kosovës.

**Neni 2**

Lista e Projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023, përfshin projektet si vijon:

1. Asfaltimi i rrugës tranzit lagjja e Konjuhët deri te rruga regjionale Lipjan-Janjevë faza II
2. Zbatimi i masave eficiente në objektin Qendra në Lipjan
3. Rehabilitimi i infrastrukturës në zonën e qendrës kulturore historike në fshatin Janjevë
4. Ndërtimi i ujësjellësit në Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavic-Babush
5. Vazhdimi i shtratit të Lumit në fshatin Smallushë faza II
6. Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugicave në Sllovi
7. Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën "Ismajl Luma" Lipjan
8. Ndërtimi i sallës së sporteve në Banullë
9. Rikonstruimi i rrugës "Fehmi Agani" Lipjan
10. Ndërtimi i shtratit të lumit dhe asfaltimi i rrugës së lumit në fshatin Gadime e Ulët
11. Përrockat(Lumejt) në Lipjan
12. Ndërtimi i qerdhës në Rufc të Ri faza e II

- 13.Ndërtimi i rrugës LLugaxhi-Babush
- 14.Ndërtimi i rrugës nga lagjja Ejupi deri te rruga që lidh Gllavicën me Gadime
- 15.Riasfaltimi i rrugës Dobratin-Sillovi
- 16.Ndërtimi i shtratit të lumit në Baicë dhe infrastruktura në burimin e ujit në Baicë
- 17.Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatit Krojmir, Kraisht dhe Zllakuqan faza e II-të
- 18.Kanalizimi në lagjen e re në Lipjan
- 19.Kanalizimi dhe Asfaltimi i rrugës në zonën ekonomike në QMI
- 20.Ndërtimi i sallës së sportit në Glllogovc faza e II
- 21.Ndërtimi i stadiumit të Magurës dhe Dobrajës faza e III

#### Neni 3

Autorizohet, Kryetari i Komunës që gjatë aplikimit për fonde të bazohet në Listën e projekteve të cekura në nenin 2 të këtij Vendimi .

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoratet përkatëse komunale

#### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15 Nr. 660/04-11054

Lipjan, më 28.02.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

